



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
Arkitekturë Dixhitale**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Polis”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Gjergj Thomai

A blue ink signature of Dr. Gjergj Thomai, consisting of a stylized first name and a horizontal line.

2. Dr. Elvan Dajko

A blue ink signature of Dr. Elvan Dajko, featuring a cursive first name and a horizontal line.

Maj / 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Polis”

Nr.	Tabela e të dhënave të licensimit për programin e studimit:	
1	IAL aplikues:	Universiteti Polis
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Arkitekturës dhe Inxhinierisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 377, 23.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1.5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Studime me kohë të zgjatur
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	NA
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	19/8
18	Numri i studentëve:	11
19	Komente / të tjera:	NA

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” është program i riorganizuar mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, si dhe në zbatim të kërkesës së MASR, për ofrimin e programeve Master Profesional në 60 Kredite ECTS.

Ky program fokusohet në thellimin e avancimeve teknologjike dhe njohurive në një Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale duke punuar me modulet me fokus të qartë në marrëdhënien e arkitekturës me mjetet e reja teknologjike që lejojnë projektimin dhe prodhimin e saj. Dijet që studentët do të përfitojnë do të lidhen ngushtë me teknikat e fundit algoritmike në projektimin algoritmik si dhe teknikat e prodhimit dixhital dhe prototipizimit të shpejtë.

Programi i studimeve Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale ofrohet nën përgjegjësinë kryesore të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit (FAD), por për ofertën akademike angazhohen edhe pedagogë nga fakultetet e tjera të POLIS, si dhe pedagogë nga universitete të huaja partnere.

Programi zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërkohë anglishtja është thujse gjuhë e dytë zyrtare. Kjo është një traditë e institucionit që ka kontribuar për komunikim më të mirë me stafin e huaj dhe ndërkombëtarizimin e programit të studimit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale”.

Bazuar në VKM Nr. 109 datë 15.02.2017, ASCAL përcakton grupin e ekspertëve për vlerësim në përbërje nga:

- Dr. Gjergj Thomai

- Dr. Elvan Dajko

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Zj. Endra Velaj. Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët përgatitën draft raportin dhe hartuan një gamë pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa pikave dhe problematikave të këtij raporti.


Gjatë vizitës së kryer në Universitetin POLIS, në datat 23-24 Shkurt 2023, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit POLIS. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Më datë 02.05.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 48/13 Prot., datë 02.05.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 04.05.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 371/23 Prot., datë 04.05.2023, institucioni ka dërguar përgjigje mbi draft raportin, duke u shprehur se nuk ka komente, si rrjedhojë raporti, merr formën përfundimtare, si raport i vlerësimit të jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin bazë të dosjes së vetëvlerësimit si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon që programi i studimit Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” ofron një kurrikulë mësimore konkurruese, programe lëndësh të përditësuara e me nivel pedagogjik e shkencor të mirëasimilueshëm, infrastrukturë e logjistike të përshtatshme dhe cilësi produkti të kërkuar në tregun e punës dhe të mirëpritur nga nivelet e tjera të studimit profesional. Cilësia e këtij produkti dhe angazhimi i tij në përdorimin e njohurive të fituara është në përputhje të plotë me interesin kombëtar për të ndërtuar sa më shumë, sa më mirë e sa më lirë.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konsultoi jo vetëm kurrikulën aktuale dhe silabuset e lëndëve, por edhe planet strategjike të institucionit dhe njësisë bazë. U gjet që ky program studimi është konkurrues në kuadrin kombëtar dhe ka ambicjen të mbetet i tillë në fushën e veprimtarisë. Në këtë perspektivë duket qartë që ky program studimi zhvillohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi i studimit Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” është konceptuar në përputhje me vizionin e Universitetit Polis, sipas të cilit arsimit i lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi dhe arkitektura dixhitale në përputhje me trendet aktuale të vendit dhe BE-së të punësimit dhe aftësive të kërkuara nga tregu, reflekton mendime të reja dhe inovative si specializim në fushën e arkitekturës.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Referuar kurrikulës së këtij programi studimi, konstatohet që ajo është hartuar e tillë që të nxjerrë produkt sa më cilësor, ndërsa referuar angazhimit të produktit të këtij programi studimi konstatohet, që ai ka kompetencën e duhur për të nxitur zhvillimin ekonomik kudo ku ai aplikohet.
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” ka funksionuar si i tillë qysh nga viti akademik 2013 – 2014. Produkti i tij tashmë ka identitet të qartë dhe është integruar plotësisht në komunitetin e profesionistëve në fushën e arkitekturës. Si i tillë,</i>



	<i>referuar RVB dhe planeve strategjike të Universitetit POLIS, ai ka dëshmuar se është në vazhden e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e shkencore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni disponon kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të nevojshme për të ofruar cilësi të lartë në këtë program studimi. Kapacitetet institucionit janë në përputhje me kurrikulën dhe llojshmërisë kurrikulare me fushën e specializimit të personelit si dhe për përcaktimin e temave, platformave studimore e udhëheqjen e studentëve deri në diplomim. Krahas stafit të brendshëm, të trajnuar brenda dhe jashtë vendit, në këtë program studimi janë angazhuar dhe staf akademik ndërkombëtar të specializuar për lëndë të veçanta. Institucioni si pjesë e një politike të brendshme për rritjen institucionale, nxit dhe mbështet kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik duke ofruar trajnime “In House”, shkëmbime në kuadër të Erasmus + dhe partneriteteve me universitete paralele në kuadër të këtyre projekteve.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Ky program studimi organizohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit i cili ka në përbërjen e tij dy departamente dhe një njësi kërkimore të cilat bashkëpunojnë në kuadër të përmirësimeve dhe përditësimeve në fushën e kërkimit për këtë program studimi. Fakulteti është njësi kryesore e bashkërendimit të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimeve në fushat e kërkimit dhe zhvillimit për këtë disiplinë. Fushat kërkimore të stafit akademik janë në përputhje dhe në funksion të programeve studimore, të cilat në një masë të madhe diktohen nga natyra e lëndëve.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Një rol shumë i rëndësishëm në kërkimin brenda këtij fakulteti përcaktohet në përputhje me qendrën kërkimore të Arkitekturës, Inxhinierisë dhe Dizajnit. Kjo njësi e tretë brenda fakultetit punon e pavarur nën drejtimin e Dr. Valerio Perna, Kjo njësi siguron bashkëpunimin me fakultetet paralele për tematika kërkimi gjithëpërfshirëse si dhe Fabrikës së Inovacionit e cila operon mbi avancimet teknologjike në arkitekturë dhe inxhinieri. Kjo qendër në bashkëpunim me departamentet përkatëse qëndron në kontakt me zyrën e projekteve për të patur një integrim horizontal, por

	dhe vertikal të tematikave të kërkimit me temat dhe fokusin evropian dhe projektet e universitetit.		
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Programi i studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale vjen si program i riorganizuar sipas Urdhërit Nr. 377, datë 23.09.2021 nga një tjetër master profesional me tre profile me 90 ECTS, i cili ofrohej në bashkëpunim me HIS/Erasmus University, Rotterdam, Hollandë. Si e tillë, U_POLIS mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, si dhe në zbatim të kërkesës së MASR, për ofrimin e programeve Master Profesional në 60 ECTS, ka vendosur të riorganizojë këtë program duke u fokusuar në thellimin e avancimeve teknologjike dhe njohurive në një “Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale”. Ky program është brenda profilit të insitucionit dhe cilësia e tij garantohehet po nga ky institucion.		
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Studentët e diplomuar nga cikli i dytë i studimeve Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale kanë mundësinë për zhvillimin e trajnimeve të mëtjshme profesionale falë kurse pasuniversitare me fokus vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe auditit energjistik të banesave por dhe programeve të tjera në nivel master profesional, fokusi i të cilave janë çështjet praktike ndërdisiplinore në fushat e arkitekturës, inxhinierisë dhe planifikimit.		
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni dhe takimet gjatë vizitës në institucion:</i></p> <p>1. GVJ gjykon se program është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe strategjinë e tij të zhvillimit.</p> <p>2. Programi është i organizuar konform kuadrit ligjor në fuqi.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB, si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton se në Universitetin Polis ka marrëdhënie bashkëpunimi funksionale midis të gjitha njërive kryesore e ato bazë brenda institucionit. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore (fakultetet). Në rastin konkret GVJ u informua për një sërë aktiviteteve me pjesëmarrje të studentëve e pedagogëve. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për



	<p>rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas.</p>		
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Përveç gjetjeve në dosjen e vetë vlerësimit, lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendës e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e zyrës së mbështetjes së studentëve, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues.</p> <p>Sipas dokumentacionit të dosjes së vetë vlerësimit, ekzistojnë marrëveshje të nënshkruara, të cilat përfshijnë edhe fushën e arkitekturës.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shoqërisë civile kombëtare dhe ndërkombëtare si Kuvendi i Shqipërisë, akademia e shkencave, instituti i monumenteve të kulturës, arkivi qendror teknik i ndërtimit, instituti italian i kulturës, Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Dropull, Bashkia Sarandë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, etj.</p>		
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ u informua gjithashtu që studentët e programit të studimit Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” mund të përfitojnë edhe nga mundësitë e ofruara nga kompani vendase apo të huaja në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, që ato kanë me universitetin. Disa nga kompanitë janë Co-plan, Metropolis, Kastrati Construction, Lindner Group, Alba Engineering, HMK Consulting, Speed Engineering, Kika Construction, Guri shpk, Everest Group, etj.</p>		
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson performancën e komponentëve për përmirësimin dhe rritjen profesionale. Të dhënat e procesit të vlerësimit paraqiten në një raport vjetor, i cili i vihet në dispozicion të senatit akademik. Mbi bazën e këtij raporti senati përpilon rekomandime konkrete për përsosjen e mësimdhënies.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, ku praktikat e studentëve zhvillohen kryesisht pranë kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” është i strukturuar në 1.5 vite akademike dhe 3 semestra të rregullt. Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Bazuar në Rregulloren e organizimit të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. Sasia totale e krediteve (ECTS), për të tre vitet akademike është 60.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” siguron formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjerë specialitetesh të përshtatshme për ambiente të ndryshme pune.</p> <p>Punëdhënësit e ardhshëm përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në kontraktorët e ndërtimeve, firmat këshilluese, studiot praktike të projektimit, agjensitë e ndryshme qeveritare, etj. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike.</p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Lëndët e parashikuara të zhvillohen në programin e studimit Master Profesional në “Arkitekturë Dixhitale” janë të larmishme e të grupuara në 5 disiplina nga lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse që përfshin teza projekt diploma. Si pasojë programi ofron njohuri të përparuara, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe aplikimit të tyre sipas parimeve akademike të fushës.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky standart nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Ky standart nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në dosjen e vetë vlerësimit, GVJ u njoh me formën e organizimit të studimit në zbatim të Rregullores Didaktike të institucionit dhe të Rregullores së Programit. Programi Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale është një program me kohë të zgjatur. Kohëzgjatja zyrtare e të cilit është 1.5 vite akademike.</p> <p>Në programin e studimeve Masteri Profesional në Arkitekturë Dixhitale, kualifikohen ata kandidatë që zotërojnë një diplomë Bachelor ose mbajtës të diplomës Master të interesuar në zhvillimin e aftësive të tyre të dizajnit dhe avancimin në profesionin e tyre si Arkitektë, Inxhinierë ose Dizajner por edhe diploma në fusha të tjera që gjykohen nga komisioni i posaçëm i vlerësimit të programeve në institucion, apo çdo titull studimi ekuivalent fituar në vende të tjera të njohura nga autoritet zyrtare dhe ligjet në fuqi.</p>


Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel,	Aktet nënligjore për kodifikimin e programeve të studimit nuk janë ende në fuqi.		
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Aktet nënligjore për kodifikimin e programeve të studimit nuk janë ende në fuqi.		
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale është i ofruar fillimisht si program studimi në bashkëpunim midis Universitetit POLIS dhe IHS – Institute for Housing and Urban Studies / Erasmus University, Hollandë. Në kërkesën e ri-organizimit ky program ofrohet nga Universiteti Polis si një program i pavarur dhe i ofruar plotësisht nga ky institucion.		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri është pjesë përbërëse e Fakultetit Arkitekturë dhe Dizajn.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale ofrohet nën përgjegjësinë kryesore të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit dhe nën përgjegjësinë e njësisë bazë të Departamentit Arkitekturë dhe Inxhinieri.</p> <p>Ky fakultet ofron programe të studimeve të cilit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master i Shkencave i Integruar, Master Profesional dhe Master Shkencor. Drejtuesi i Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit (FAD), është Dekani Dr. Ledian Bregasi. Dekani koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësive kryesore.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, është Përgjegjësi i Departamentit, Dr. Fabrizio Aimar. Përgjegjësi i</p>

	<p>Departamentit përveç përgjegjësive që mban si drejtues i njësisë bazë, ushtron edhe funksione të tjera të përcaktuara në Statutin e Universitetit POLIS.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Fakulteti është njësia kryesore akademike e Universitetit Polis, që koordinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat mësimore-kërkimore. Universiteti Polis është i përbërë nga 3 (tre) fakultete. Autoritetet udhëheqëse akademike janë Dekani dhe Përgjegjësit e Departamenteve. Organi kryesor akademik i fakultetit është Dekanati. Autoriteti kryesor administrativ është Administratori i Fakultetit.</p> <p>Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn përbëhet nga 2 (dy) departamente dhe 1 (një) njësi kërkimore shkencore, të cilët funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri; 2. Departamenti Art dhe Dizajn; 3. Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn. <p>Nga sa më sipër njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Koordinatori i programit të studimit është Dr. V. Perna. Në vendim shpjegohen detyrat kryesore të koordinorit të programit, si mëposhtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Monitoron dhe koordinon procesin mësimor, në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore dhe fakultetin përgjegjës; 2. Koordinon dhe bashkëpunon me studentët duke i mbështetur, dhe ndihmuar për proceset akademike, i orienton ata drejt njësive me të cilat duhet komunikojnë për tematika të ndryshme; 3. Monitoron dhe koordinon me dekanatin, zbatimin e kurrikulës, hedhjen e saj në sistemin elektronik në kohë nga përgjegjësit e kurrikulës; 4. Bashkëpunon me NJBSC, dhe sigurohet që procesi i vlerësimit është kryer nga studentët dhe stafi i programit në fjalë; 5. Identifikon rezultatet dhe pritshmëritë e programit, krahasuar me zhvillimet e tregut si dhe ofertat e aktorëve të tjerë në treg për këtë program ose programe të ngjashme me të.
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstanton se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinierisë zotëron informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Master profesional në Arkitekturë Dixhitale. Anëtarët e GVJ u vunë në dijeni lidhur me një sërë dokumentacionesh si nga plani strategjik i programit të studimit, plani strategjik i universitetit, statuti i universitetit, plani i financimit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja didaktike, rregullorja e NJSBC, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në rregulloren e programit të studimit. Mbështetet në parimin e kontrollit të vazhduar dhe mënyra e vlerësimit varet nga tipologjia e lëndës.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. Institucioni, nëpërmjet zyrës së pranimeve, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranim, transfertë dhe njehsim studimesh. Të gjitha informacionet janë bërë publike dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të universitetit, si dhe janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë	Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë. Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e



auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.						
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Plani mësimor përcaktohet në formë vjetore, kurrikulat janë objekt i rishqyrtimit periodik nga personeli akademik në përputhje me procedurat përkatëse ku ndryshimet kalojnë procesin e miratimit nga Senati Akademik. Programi mësimor përcakton lëndën, modulën, profesorin, asistentët e lëndës, orët totale, ndarjen e orëve dhe kreditet përkatëse për çdo kategori, formën e vlerësimit dhe ndarjen javore të lëndëve.						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit është i detajuar dhe i strukturuar në përputhje me objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. Të gjitha detajet në lidhje me organizimin e programit të studimit janë të miratuara dhe të paraqitura në çdo vit akademik në Planin Mësimor, Rregulloren Didaktike dhe Rregulloren e Programit të Studimit.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të nxënies, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. Në semestrin e parë zhvillohen aplikime të llogjikës kompjuterike dhe algoritmike në projektim si dhe algoritme gjenerative në krijimin dhe konceptimin e formave arkitektonike. Më tej kalohet gradualisht në lëndë më profesionale ku bëjnë pjesë elementë të botës fizike në procese krijimi dixhitale ku njihen me mjetet e prodhimit dixhital si CNC, 3D printer të cilat do shërbejnë për prototipizime dhe procese eksplorative si dhe automatizimin e proceseve të prodhimit. Studentët zhvillojnë laboratore në lëndë të ndryshme, praktikë profesionale, si edhe njihen me përdorimin e programeve kompjuterike në projektim.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënies dhe kërkimit shkencor.	Programi me organizimin e tij bazuar dhe në Rregulloren e tij, ka për qëllim të thellojë njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Programi synon të pajisë studentët e nivelit Master me njohuri multidisiplinare dhe aftësinë për të analizuar dhe kuptuar larminë e disiplinave dhe aktorëve të përfshirë në procesin gjithnjë e më shumë të zhvillimit urban dhe për ta përkthyer këtë në plane dhe skema. Gjithashtu organizimi i programit të studimit në lëndë/module dhe shpërndarja në semestra me orët dhe kreditet mësimore të ofruara nga


	ky program janë në përputhje të plotë me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve dhe bazës ligjore për arsimin e lartë.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmblyëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në laboratorin IF pranë ambienteve të institucionit.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabusi reflekton programin dhe metodologjinë e zhvillimit të lëndës dhe është subjekt përmirësimi vjetor nga pedagogu i lëndës duke konsideruar përditësimet e vazhdueshme në literaturë që kjo disiplinë kërkon. Programi i studimit hartohet dhe rishikohet duke konsideruar, zhvillimet më të fundit shkencore në fushën e arkitekturës, kërkesat me tregun e punës, rekomandime nga sektori i biznesit si dhe rekomandime nga rrjeti Alumni.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Ky program studimi ofrohet në përputhje me synimet dhe misionin e institucionit, në përputhje me profilin kulturor dhe profesional që synon të formojë, me përmbajtje e strukturë në respektim të të gjitha standarteve akademike e përmbajtësore për programet ciklit të dytë dhe nën përgjegjësinë e një stafi akademik si efektiv dhe të ftuar me kualifikimin dhe ekspertizën e duhur dhe cilësore për këtë program.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

Konkluzione	<i>Emërtimi, përmbajtja, objektivat, vizioni dhe standartet e përcaktuara për këtë program studimi janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
			X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Përmirësimi i programit mësimor dhe përputhshmëria e tij me kërkesat dhe tregun e punës është një domosdoshmëri. Përmirësimi periodik ndodh gjithmonë në bashkëpunimin me studime të vazhdueshme të tregut, ku përfshihen një sërë të dhënash që njihojnë në hartimin e kurrikulave dhe vendimmarrjes institucionale që i përket organizimit të programeve të studimit. Kurrikulat organizohen në përputhje me tendencat e zhvillimit kulturor, ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe në harmoni me zhvillimet në tregun e punës. Për rishqyrtimin periodik dhe përmirësimin e tyre të vazhdueshëm, funksionon procedura e ndjekur me marrjen dhe analizimin e “feed-back” të vazhduar nga studentët e diplomuar duke parë ecurinë dhe ndëmarrë korigjimet përkatëse dhe të nevojshme për propozimin e ndryshimeve të kurrikulës, nga anëtarët e departamentit përkatës, aprovimin e tyre në dekanat, dhe së fundmi miratimi i ndryshimeve në Senatin Akademik.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët gjithashtu janë pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Përfaqësues të studentëve janë të përfaqësuar në organet më të larta drejtuese të U_POLIS, si Senati Akademik, ashtu dhe në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, në këtë mënyrë ata janë pjesë e vendimmarrjes dhe kanë mundësi të shprehim mendimin e tyre mbi përmbajtjen dhe mënyrën e zhvillimit të lëndëve të programit. Kjo përfaqësi është shumë mirë e rregulluar nëpërmjet Senatit Studentor.
Kriteri 3. Njësitë përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e	Një vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu zgjerimit të rrjetit të partneriteteve jo vetëm me institucione ndërkombëtare e lokale të sektorit të arsimit, por dhe me aktorë të ndryshëm nga komuniteti i biznesit, organizmat qeveritare dhe joqeveritare, shoqata dhe organizata profesionale, etj. Disa nga këto partneritete kanë sjellë ndërkombëtarizim të këtij universiteti në Evropë dhe përcjellin rëndësinë, cilësinë dhe seriozitetin me të cilin ky program operon. Këtu


mjekësisë) dhe institucione publike e private.	mund të përmendim Shoqatën Europiane për Arsim në Arkitekturë EAAE e cila organizon workshope e seminare periodike të cilat kanë në qendër të vëmendjes përditësimin e vazhdueshëm të programeve mësimore si dhe lidhjen e tyre gjithnjë e më të fortë me tregun e punës. Një bashkëpunim tjetër i rendësishëm për përditësimin dhe përshtatjen e programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fushën e arkitekturës dhe dizajnit urban është ai me Unionin Shqiptar të Arkitektëve Urbanistëve dhe Planifikuesve Urban ku nëpërmjet takimeve dhe aktiviteteve të organizuara nga unioni merret një feedback i drejtpërdrejtë nga arkitektët dhe urbanistët e anëtarësuar në union. Njësia përgjegjëse punon në vazhdimësi më të gjithë partnerët, aktorët dhe palët e interesuara për të ofruar asistencën e tij dhe ekspertizën në tematika të caktuara dhe për tu përditësuar mbi zhvillimet më të fundit të tregut të punës.		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në përgjigje të gjendjes lokale dhe asaj globale si dhe në raport me çështjet kryesore që shtrohen sot për zgjidhje universiteti është përpjekur që nëpërmjet një procesi të gjatë reflektimi të mirëpërcaktojë dhe konsolidojë misionin e tij institucional dhe objektivat kryesore të zhvillimit të mëtejshëm. Konsolidimi dhe përparimi i kërkimit shkencor bazuar në metodat bashkëkohore dhe inovative është një nga objektivat kryesore të institucionit.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore bashkërendon veprimtaritë e mësimdhënies, me veprimtaritë kërkimore duke respektuar lirinë akademike të stafit të saj. Fakulteti si njësia kryesore që bashkërendon, administron dhe menaxhon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta dhe është i organizuar në dy departamente. Këto departamente “kujdesen” për përmbushjen e kërkesave dhe standarteve të mësimdhënies së bashku me stafin akademik. Në përputhje me Statutin e institucionit dhe Rregulloren e Përgjithshme, stafi vepron në liri të plotë dhe të pavarur akademike për të ofruar, cilësinë më të lartë të mësimdhënies dhe rritjen e angazhimit në kërkimin shkencor.




Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit 2021-2026 të Universitetit POLIS, që ka të bëjë pikërisht me përcaktimin e mënyrës së zhvillimit të kërkimit shkencor në universitet, sipas së cilit Universiteti POLIS, në ndjekje dhe zbatim të misionit të tij për të krijuar, zhvilluar, transmetuar dhe mbrojtur njohuritë teknologjinë dhe lidhshimin për zhvillim dhe inovacion, në pesë vitet e ardhshme parashikon të bëhet një institucion që gëzon reputacion ndërkombëtar për kërkimin inovativ gjithëpërfshirës dhe ndërdisiplinor me pjesëmarrje aktive të studentëve.		
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Në nivel departamenti, çdo vit hartohet plani vjetor i kërkimit shkencor, i cili miratohet në nivel dekanati. Pjesë përbërëse e këtij plani është edhe plani i shpenzimeve, që parashikon mbështetjen financiare të formave të ndryshme të kërkimit shkencor.		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka gjithë kapacitetin njerëzor, financiar, infrastrukturor për të kryer një kërkim shkencor dhe punon në vazhdimësi për bashkëpunime në projekte të cilat nxisin kërkimin dhe inovacionin.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	U_POLIS në filozofinë e tij ka një qasje tërësore në procesin akademik ku integrimi i aspekteve të formimit teorik me atë kërkimor shkencor dhe praktik, përbën thelbin e formimit. Për këtë arsye janë ndërtuar marrëdhënie të ngushta jo vetëm me njësitë brenda strukturës së institucionit por dhe bashkëpunim me organizma të ndryshëm publikë dhe privatë, që plotësojnë gamën e njohurive profesionale nga ana e studentit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Programi i studimit i kushton vëmendje të veçantë mënyrës së organizimit dhe ofrimit të kurrikulës si dhe ndarjen e qartë midis teorisë dhe praktikës, punës me projektet çka kërkim krijimin e punës në grup jo vetëm nga ana e studentëve por dhe e stafit të angazhuar në këtë program. Për projekte të caktuara kërkimore dhe shkencore Universiteti POLIS mbështet krijimin e grupeve lëndore dhe grupeve të përziera të punës. Këtu mund të jepen shembujt e studiove të integruara me karakter ndërdisiplinor me qëllim që të ndërtohet kultura e punës në ekip dhe kolegialiteti në performancë dhe vendimmarrje pas daljes në punë.




<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Programi i studimit në Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale në Universitetin POLIS përbën një vlerë të shtuar në formën e një rrjeti ndërkombëtar teoriko-praktik. Konferencat e aktiviteteve të organizuara nga Fakulteti dhe Departamenti me qëllim arritjen e objektivave të programit të studimit janë të shumta në numër e në natyrë, por disa prej tyre spikasin dhe përbëjnë një nga tiparet dalluese të programit të studimit e të institucionit në tërësi. Ndër to mund të përmendet organizimi i dy bienaleve TAW Tirana Architecture Weeks dhe TDW Tirana Design Weeks.</p>		
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Masteri Profesional në Arkitekturë Dixhitale është i ndërtuar në mënyrë të tillë për të pajisur studentët me njohuri, metodologji dhe kompetenca teknike të avancuar të cilat u japin mundësi për të qenë në një pozicion shumë të avantazhuar në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Për vetë natyrën e programit të studimit, tematikat e mbuluara dhe programet kompjuterike të përdorura janë ato që përdoren në studio më të mëdha dhe të rëndësishme të projektimit arkitektonik në botë.</p>		
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Në mënyrë specifike për programin e studimit, Universiteti POLIS është partner me shoqatën eCAADe European Computer Architectural Aided Design in Education, bashkë me të cilën janë organizuar shkëmbime si dhe është organizuar njëra nga konferencat e përvitshme të shoqatës pranë institucionit. Në nivel kombëtar, Universiteti POLIS është anëtar i Unionit Shqiptar të Arkitektëve Urbanistëve dhe Planifikuesve Urban ku falë këtij bashkëpunimi, Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit si dhe Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë marrin pjesë në diskutimet ligjore si dhe në iniciativat për rregullimin e profesionit. Në këtë mënyrë merren parasysh dhe zbatohen rekomandimet për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>		
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Pavarsisht se programi i studimit është Master Profesional, ai ndjek dhe është në përputhje me rregullat dhe aktet ligjore në vend dhe fuqi si dhe me rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian në lidhje me profesionet e rregulluara.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni dhe takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ gjykon se programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X



Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga vlerësimi i programit mësimor dhe i silabuseve si dhe nga vizita në terren, gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët u evidentua se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në programin e studimit janë të shumëllojshme. Ato përfshijnë leksionet, seminarët, punën në laboratorët e prototipizimit dixhital, detyrat e kursit, projektet, praktika profesionale pranë partnerëve të tregut dhe industrisë si dhe leksionet e hapura dhe workshopet kushtuar tematikave të veçanta të programit të studimit.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga intervistat me studentët dhe me personelin akademik u vu re se përveç formave të mësipërme të mësimdhënies, vetë natyra e programit të studimit dhe mënyra e organizimit të tij u jep mundësi pedagogëve jo vetëm të respektojnë por edhe tu përgjigjen larmisë së kërkesave dhe nevojave të studentëve. Shumica e lëndëve kanë në përbërjen e tyre edhe komponente studio/atelier gjatë së cilave studentët punojnë në kontakt të ngushtë me personelin akademik duke u përballuar bashkarisht me problematikat e projektimit si dhe duke shkëmbyer ide, qasje dhe instrumente për metodologjitë e mundëshme të përballjes me tematikën e secilës lëndë.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Nga raportin e vlerësimit të brendshëm, nga dokumentacioni i paraqitur nga institucioni si dhe nga vizita në terren u evidentua se institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktik, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Kjo mbështetje ndodh duke filluar me trajnimet e brendëshme të organizuara nga institucioni ku trajtohen çështje metodologjike të mësimdhënies dhe të didaktikës. Paralele me këtë institucioni organizon seminarë dhe konferenca të cilat trajtonë aspekte bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit në arkitekturë. Personeli akademik nxitet të marr pjesë në konferenca ndërkombëtare duke mbuluar pjesë të shpenzimeve për pjesëmarrësit. Nga ana tjetër institucioni është partner në një numër projektesh Europiane Erasmus+ të cilat synojnë ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e metodave inovative në mësimdhënie. Këto programe lejojnë edhe shkëmbimin e personelit akademik nga dhe prej institucionit. Personeli akademik ka



	<p>gjithashtu mundësinë që të aplikojë dhe të rregjistrohet në Programin Ndërkombëtar të Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban, i organizuar bashkë me Universitetin e Ferrarës. Në këtë program, personeli akademik ka mundësinë të zgjerojë dhe thellojë më tej njohuritë dhe kompetencat teknike e metodologjike.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve si dhe përdor metoda të ndryshme për ta bërë mësimin ndërveprues dhe për të nxitur mendimin kritik dhe atë krijues tek studentët. Kjo gjë vihet re në formimin dhe eksperiencën e personelit akademik të përzgjedhur për tu angazhuar në këtë program studimi, nga metodologjia e mësimdhënies e përshkruar në silabusin e lëndëve, nga përgjigjet e studentëve të intervistuar si dhe nga rezultatet a arritura në lëndët dhe modulet e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Fakulteti i arkitekturës dhe Dizajnit si dhe Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë marrin feedback nga studentët nëpërmjet pyetësorëve të përvitshëm dhe sistemit të vlerësimit nga studentët. Informacion dhe vlerësime merren nga alumni dhe nga partnerët e tregut. Ky informacion shërben si bazë për përmirësimin dhe përditësimin periodik të metodave të mësimdhënies</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në nivel institucional NJBSC ndjek nga ana cilësore organizimin e mësimdhënies si dhe organizon proceset e vlerësimit të brendshëm me anë të pyetësorëve dhe të sistemit të vlerësimit 360 gradë ku përfshihen studentët, kolegët, vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga eprorët. Ky proces jep të dhëna sasiore dhe cilësore të cilat përdoren për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Nga ana tjetër njësitë bazë dhe ajo kryesore organizojnë trajnime dhe konferenca për të nxitur zhvillimin e mëtejshëm të metodave të cilat nxisin personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. Njësia ndërdepartamentale Innovation Factory mbështet pedagogët për të zhvilluar metoda eksperimentale dhe për të patur akses në teknikat e reja inovative.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni, programit mësimor dhe i silabuseve si dhe nga vizita në terren, gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët u evidentua se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në programin e studimit janë të shumëllojshme duke përfshirë leksionet, seminarët,</i></p>

	<p><i>punën në laboratorët e prototipizimit dixhital, detyrat e kursit, projektet, praktika profesionale pranë partnerëve të tregut. Natyra e programit të studimit dhe mënyra e organizimit të tij u jep mundësi pedagogëve të respektojnë dhe tu përgjigjen larmisë së kërkesave dhe nevojave të studentëve. U evidentua se institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktik, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve si dhe përdor metoda të ndryshme për ta bërë mësimin ndërveprues dhe për të nxitur mendimin kritik dhe atë krijues tek studentët. Njësia kryesore dhe ajo bazë marrin feedback nga studentët nëpërmjet pyetësorëve të përvitshëm dhe sistemit të vlerësimit nga studentët. Ky informacion shërben si bazë për përmirësimin dhe përditësimin periodik të metodave të mësimdhënies. Institucioni ka të ngridura një numër strukturash të posaçme në nivelin bazë dhe institucional të cilat mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyset plotësisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore janë publike në institucion dhe në website. Këto kritere përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të universitetit dhe më pas detajohen në rregulloren didaktike dhe atë të programit të studimit. Në to përcaktohen kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore. Gjatë vizitës në terren u evidentua se studentët ishin të njohur me to.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Titullari i lëndës informon studentët në fillim të çdo lënde mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset. Syllabuset janë të aksesueshme nga studentët edhe në sistemin e brendshëm Pitagora. Gjatë vizitës në terren u evidentua se studentët ishin të njohur me këto informacione.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke parashikuar detyra të ndërmjetme, dorëzime projektesh, prezantime

ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	publike dhe provime e dorëzime përfundimtare projektsh. Këto mënyra i japin mundësi studentëve të tregojnë aftësitë dhe njohuritë e zhvilluara gjatë programit.						
Konkluzione	<i>Nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni, programit mësimor dhe i silabuseve si dhe nga vizita në terren, gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët u evidentua se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore janë publike. Këto kritere përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të universitetit dhe më pas detajohen në rregulloren didaktike dhe atë të programit të studimit. Titullari i lëndës informon studentët në fillim të çdo lënde mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset. Syllabuset janë të aksesueshme nga studentët edhe në sistemin e brendshëm Pitagora. Testimi e vlerësimi në njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke parashikuar detyra të ndërmjetme, dorëzime projektsh, prezantime publike dhe provime e dorëzime përfundimtare projektsh.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni, programit mësimor dhe i silabuseve si dhe nga vizita në terren, gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët u evidentua se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. Ky fakt reflektohet edhe në procesverbalet përfundimtare të notave ku vlerësimi është rezultat i shumatores së vlerësimeve të ndërmjetme që zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni përdor disa sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimt për të shmangur abuzimin e për të rritur transparencën. Disa prej testeve organizohen në platformën Google Form ku jepet mundësia për të krijuar teste “multiple choice” ku automatizimi i procesit shmang ndërhyrjet e jashtme. Detyrat e ndërmjetme dhe përfundimtare dorëzohen në account-in institucional në platformën Google Classroom si dhe për të shmangur plagjiaturën përdoret account-i institucional në platformën TurnItIn.


Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet sipas bazës ligjore në fuqi dhe duke ndjekur parashikimet e syllabusit. Ky fakt u verifikua edhe duke parë përputhjen e syllabusit me procesverbalin e vlerësimit të lëndëve.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Dorëzimet përfundimtare të lëndëve zhvillohen në mënyrë të hapur dhe nëpërmjet prezantimeve publike. Gjatë prezantimeve pedagogët e lëndës si dhe pedagogët të ftuar japin komente mbi punën e dorëzuar si dhe feedback mbi procesin e zhvilluar gjatë lëndë. Këto çështje u evidentuan edhe nga takimet me studentët si dhe me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Fakulteti dhe departamenti, në bashkëpunim me trupën e pedagogëve marrin masat e nevojshme për të shmangur dhe mos lejuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime e detyra. Ky fakt u vu re gjatë intervistave me studentët dhe personelin pedagogjik si dhe nga përdorimi i sistemeve të ndryshme ku dorëzohen dhe kontrollohen detyrat.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloren didaktike. Këto çështje u evidentuan edhe nga takimet me studentët si dhe me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni u garanton studentëve të drejtën për tu njohur me vlerësimet duke i bërë ato të aksesueshme si në sekretarinë mësimore ashtu edhe nëpërmjet sistemit Pitagora. Gjithashtu studentët kanë të drejtën të kërkojnë rishikimin e vlerësimit në përputhje me statutin dhe rregulloret e institucionit.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rregullore parashikohen edhe procedurat që ndiqen në rast ankimi ku ngrihet një komision i posaçëm. Kjo procedurë është e hapur dhe transparente për palët e përfshira. Në rast se shfaqet kërkesa për ankimim, procesi dokumentohet dhe arkivohet.
Konkluzione	<i>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucion si dhe nga vizita në terren dhe intervistat me personelin akademik, atë administrativ dhe me studentët u evidentua se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. Institucioni përdor disa sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimt për të shmangur abuzimin e për të rritur transparencën. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet sipas bazës ligjore në fuqi dhe duke ndjekur parashikimet e syllabusit. Dorëzimet përfundimtare të lëndëve zhvillohen në mënyrë të hapur dhe nëpërmjet prezantimeve publike ku pedagogët e lëndës japin komente mbi punën e dorëzuar si dhe feedback mbi procesin e zhvilluar gjatë lëndë. Institucioni u garanton studentëve të drejtën për tu njohur me</i>

	<p>vlerësimet duke i bërë ato të aksesueshme si në sekretarinë mësimore ashtu edhe nëpërmjet sistemit Pitagora. Në rregullore parashikohen edhe procedurat që ndiqen në rast ankimi ku ngrihet një komision i posaçëm. Kjo procedurë është e hapur dhe transparente për palët e përfshira dhe në rast se shfaqet kërkesa për ankimim, procesi dokumentohet dhe arkivohet.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit garanton pajisjen e studentëve me njohuri të thella shkencore dhe me aftësi bashkëkohore profesionale. Garantimi i thellimit të njohurive dhe aftësive profesionale vihet re në mënyrën e organizimit të programit të studimit, në përmbajtjen e syllabuseve, në përzgjedhjen e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie si dhe në laboratorët dhe instrumentet e vëna në dispozicion të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit pajis studentët e aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit e ndërveprimit në fushën e arkitekturës dhe projektimit. Këtë gjë e bën edhe nëpërmjet leksioneve e prezantimeve në gjuhën angleze.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Syllabusi i lëndës është i orientuar ndër të tjera edhe drejt <i>teaching and learning outcomes</i>. Në këtë mënyrë, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti janë të parashikueshme dhe mund të analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. Po ashtu, në këtë mënyrë mundësohet që pedagogët të orientojnë studentët për arritjen e kompetencave si dhe për detyrimet përmbyllëse që rrjedhin prej syllabusit.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara;</p>	<p>Pedagogët e realizojnë mësimdhënien edhe duke u bazuar në kompetencat me të cilat duhet të pajisen studentët. Këto kompetenca zhvillohen edhe nëpërmjet punëve laboratorike, praktikave profesionale si dhe falë mbështetjes nga personeli akademik i diskutimeve, punës në grup dhe problem-based. Në këtë mënyrë krijohet një klimë e përshtatshme për shfaqjen dhe zhvillimin e ideve inovative. Shpesh detyrat e kursit zhvillohen mbi tematike konkrete dhe në bashkëpunim me institucione partnere duke pajisur studentët</p>



krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	meaftësi për të zgjidhur probleme konkrete dhe duke u i mundësuar bërjen pjesë e një rrjeti sa më të gjerë profesional.		
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik efektiv dhe i ftuar, parë natyrën e veçantë të programit të studimit, është shumë i përfshirë në zhvillimet e fundit të shkencës, teknologjisë dhe profesionit. Ky personel zhvillon rregullisht orë të hapura e prezantime mbi këto zhvillime duke pasuruar ofertën formuese të programit të studimit.		
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative falë pranisë së Innovation Factory dhe programeve të inkubimi. Gjithashtu Universiteti POLIS është njëri ndër partnerët themelues të Tirana Inc. (https://www.tirana-inc.al/) inkubatori i bizneseve që ofron mbështetje infrastrukturore, mentorim dhe financim të idevë inovative të të rinjëve e studentëve.		
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni parashikon në rregulloren e programit të studimit detyrimet përmbyllëse. Për programin e studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale parashikohet që pasi të jenë përyllur detyrimet që përcillen nga çdo lëndë dhe pasi të jetë zhvilluar praktika profesionale, të harohet një projekt diplome. Kjo procedurë është publike në rregullore. Në intervistat me studentët u evidentua gjithashtu se ata janë të informuar nëpërmjet disa rrugëve për këto parashikime.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e	Drejtuesit e njësive, pedagogët dhe njësitë administrative asistojnë studentët duke u vënë në dispozicion të gjithë informacionin, udhëzimet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e detyrimeve përmbyllëse. Për hartimin e projektit të diplomës parashikohet në orar dhe është vënë në dispozicion të studentëve një grup me pedagogë të

nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	cilët udhëheqin dhe asistojnë studentët në mënyrë individuale dhe të personalizuar.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Mbrojtja e diplomës kryhet para një komisioni të posaçëm. Në mbrojtjen e diplomës studenti duhet që nëpërmjet projektit të tregoj zotërimin e njohurive teknike dhe metodologjike të marra përgjatë zhvillimit të lëndëve të programit në raport me peshën specifike të secilit modul.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Procesi i përgjedhjes së temës së punimit të diplomës udhëhiqet nga pedagogët e lëndës së Labororit të Integruar Tezës së Diplomës. Këta pedagogë orientojnë studentët për temën e përzgjedhur si dhe mbi fushat që duhet të mbulojë kjo punë. Lënda e Labororit të Integruar të Tezës së Diplomës është e organizuar në mënyrë të tillë që parashikon punë të mbikqyrur dhe të pavaruar në laboratorin e prototipimit dixhital pranë institucionit. Puna në laborator ndihmon në krijim e projekteve që përmbajnë aspekte teorike, teknologjike dhe inovative. Pedagogët e lëndës ofrojnë asistencë nëpërmjet konsultave, duke orientuar punën eksperimentale si dhe duke garantuar cilësinë e duke miratuar punën përpara paraqitjes para komisionit.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni vë në dispozicion të gjitha pajisjet laboratorike të laboreve të ndryshme për të asistuar studentët në kryerjen e matjeve, analizave, testeve dhe prototipizimeve. Institucioni vë në dispozicion gjithashtu ambientet si dhe laborantë dhe personel ndihmës për të garantuar mbarëvajtjen e punës laboratorike.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të mbrojtjes së punës së diplomës studenti vlerësohet me notë
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën si dhe suplementin e diplomës të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Studenti pajiset gjithashtu me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan dhe disponon në arkivë, në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit përkatës për secilin student. Ky dokumentacion vihet në dispozicion rast pas rasti nëse kërkohet.

Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e asiston atë në përgatitje si dhe e pajis atë me dokumentacionin e nevojshëm.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
			X


Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitim të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Institucioni, nëpërmjet njësisë kryesore dhe asaj bazë ka venë në dispozicion të programot të studimit ambiente të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike dhe asaj profesionale. Nga dokumentacioni i venë në dispozicion nga institucioni si dhe nga vizita në institucion, këtu mund të përmenden labororet e projektimit dhe të prototipizimit dixhital të Innovation Factory, laboratorit të Computer Aided Design, laboratorit të modelimit dixhital 3D dhe ai i dizajnit algoritmik, laboratorit të efikasitetit energjetic dhe i impianteve teknologjike dhe laboratorit të Realitetit të Shtuar e Virtual AR/VR.		
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Përveç laboratoreve të sipërpërmendura, institucioni garanton një rrjet partnerësh për realizimin e stazheve dhe praktikave profesionale. Këtu mund të përmenden rastet e evidentuara nga dokumentacioni i venë në dispozicion nga institucioni si dhe nga vizita në terren ku një numër i konsiderueshëm i studentëve të vitit të dytë ishin duke zhvilluar apo kishin zhvilluar stazhe në studiot të angazhuara në zhvillimet më të fundit teknologjike e profesionale në vend.		
Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale e zhvilluar gjatë studimeve, e dokumentuara sipas formatit të institucionit si dhe të shoqëruara me mendimin dhe vlerësimin e trajnerëve, miratohet nga institucioni dhe ekuivalentohet në kredite. Ky dokumentacion arkivohet nga institucioni.		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve. Kjo procedurë dokumentohet dhe vlerësohet nga institucioni.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
			X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III			Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik efektiv dhe me kontratë i përfshirë në këtë program studimi plotëson të gjitha kapacitetet akademike dhe shkencore për të ofruar me cilësi këtë program studimi, jo vetëm në terma sasiore por edhe atë të kualifikimit të stafit. Ofrimi i programit në përputhje me profilin kulturor, profesional synon të formojë, me përmbajtje e strukturë në respektim të të gjitha standardeve akademike e përmbajtësore për programet e integruara të ciklit të dytë dhe nën përgjegjësinë e një stafi akademik si efektiv dhe të ftuar me kualifikimin dhe ekspertizën e duhur dhe cilësore për këtë program. Stafi i këtij universiteti gëzon titujt dhe gradat e nevojshme për të realizuar mësimdhënien në këtë program studimi, në bashkëpunim me stafin e jashtëm dhe stafin e ftuar në program realizojnë një proces të plotë dhe mbulojnë të gjithë modulet të këtij programi në përputhje me kualifikimin që stafi ka.
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Kërkesat ligjore ashtu edhe nevojat praktike për t'i ofruar studentëve njohuri të nivelit të lartë në fushën e arkitekturës dhe dizajnit urban plotësohen nga personeli i përfshirë në mësimdhënie por edhe nga drejtuesit e programit dhe të njëjve si në nivel titujsh e gradash, ashtu dhe kualifikimesh në përputhje me programin e studimit. Të gjithë drejtuesit e programit, të njëjve si dhe pedagogët e lëndëve kanë profil akademik në fushën e arkitekturës, inxhinierisë dhe dizajnit.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Personeli akademik i angazhuar në programin Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale tregon nivele profilizimi dhe specializimi të lartë për nga vetë natura specifike e programit të studimit. Ky personel është prej vitesh pjesë e stafit kyc të Universitetit POLIS dhe vazhdon eksperiencën e ndërtuar ndër vite me programin Master Profesionale ne Dizajn Parametrik duke dëshmuar qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe	Në bazë të Rregullores së Përgjithshme të institucionit, departamenti dhe fakulteti përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik

<p>vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>të nevojshëm si dhe në vlerësimin e tij. Rekrutimi i personelit akademik të profilit të propozuar nga departamentet kthehen në terma reference të qarta duke përcaktuar detyrat e personelit të kërkuar dhe profilin e tij.</p> <p>Universiteti POLIS ndjek një politikë të qartë në drejtim të rekrutimit të stafit akademik synim i së cilës është tërheqja e stafit kryesisht të huaj të kualifikuar me grada e tituj shkencor, dhe me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Aktualisht U_POLIS plotësimin e nevojave për staf të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë ka aritur të realizojë duke punësuar profesionistë vendas dhe të huaj me përvojë në fushën akademike. Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me nevojat për pedagogë, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/Departamenti, si dhe ngarkesat mësimore të miratuara. Synimi kryesor është zhvillimi i ngarkesës mësimore kryesisht me personel të brendshëm e të qëndrueshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Të gjithë laboratorët e Universitetit POLIS u janë caktuar persona përgjegjës të cilët janë personel ndihmës akademik. Ky personel njihet në detaj pajisjet e laboratorëve dhe në momentin e marrjes në dorëzim të pajisjeve të reja është i pranishëm në instalimin dhe merr trajnime të posaçme për përdorimin e pajisjeve laboratorike. Personeli ndihmës akademik asiston gjithashtu pedagogët dhe studentët në përdorimin e pajisjeve të avancuara laboratorike si dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e laboratorit në tërësi si dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve në veçanti.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>U_POLIS për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, plotëson dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga Zyra Rajonale e Punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuara si dhe materiale të tjera të kërkuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Juridike.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore disponon databazën e plotë për të gjithë personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, së bashku me dokumentacionet e secilit. Të gjithë këta persona të angazhuar në programin e studimit, duke shtuar edhe zyrën e IT si staf administrativ i angazhuar në zhvillimin e praktikave laboratorike, janë pjesë e të dhënave që ruhen të përmbledhura në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Protokollit.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe</p>	<p>Universiteti nxit bashkëpunimin dhe ndërveprimin mes antarëve të njësisve si në nivel institucional dhe në nivel ndërinstytucional. Kjo është një veprimtari e vazhdueshme në kuadër të projekteve të përbashkëta, pjesëmarrja në programeve kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.</p> <p>Vëmendje të veçantë i kushtohet gjithashtu zgjerimit të rrjetit të</p>




mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	partneriteteve jo vetëm me institucione ndërkombëtare e lokale të sektorit të arsimit, por dhe me aktorë të ndryshëm nga komuniteti i biznesit, organizmat qeveritare dhe joqeveritare, shoqata dhe organizata profesionale çka ndihmon dhe bën të mundur mbështetjen e studentëve në praktikat profesionale që ata duhet të realizojnë gjatë studimeve.		
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Për programin e studimit, Masteri Profesional në Arkitekturë Dixhitale parashikohej që të gjithë studentët e regjistruar në program të mund të zhvillojnë praktikën profesionale pranë laboratorit të parafabrikimit dixhital të IF Innovation Factory. Praktika profesionale e zhvilluar në IF u lejon studentëve të përdorin pajisje të avancuara të fushës së arkitekturës dixhitale dhe në të njëjtin moment u garanton edhe udhëheqjen dhe asistencën e personelit akademik si dhe të atij mbështetës. Ky personel është më vonë në gjendje të raportojë mbi përmbushjen e detyrimeve të praktikës profesionale.		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në RVB si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton që Universiteti Polis vë në dispozicion ambiente shumë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe natyrën specifike të programit të studimit. Studentët kishin akses në auditore, laboratorë, bibliotekë dhe mjediset ndërmjetëse për t'i përdorur si ambientet ashtu edhe teknologjinë mësimore të vendosur në këto ambiente sipas nevojës.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në ambientet mësimore të institucionit GVJ konstatoi se mjediset mësimore ishin të pajisura me pajisjet e nevojshme të teknologjisë së informacionit si: kompjutera, projektues, internet me kabull dhe wifi. Po ashtu laboratorët e ndryshëm si FAB-Lab ishte i pajisur me pajisje të teknologjisë së fundit dhe me të gjitha softet për zhvillimin e procesit mësimor konform programit.

<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ konstatoi që për programin e studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale, institucioni kishte vënë në dispozicion të procesit mësimor e kërkimor - shkencor laboratorin IF (Innovation Factory). Në të gjithë mjedisin laboratorik ishin instaluar paisjet e duhura dhe softet e përshtatshme në përputhje me realizimin e të gjitha objektivave të procesit mësimor e kërkimor - shkencor si dhe një sërë softwarësh të tjerë si psh (BIM, Revit, AutoCAD etj) të nevojshëm për një proces mësimor efektiv.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në universitetin POLIS, GVJ gjeti 3 laboratorë të teknologjisë së informacionit të pajisura me programe profesionale të cilat ofronin shërbime sipas kërkesave specifike të programit.</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ofron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e praktikave si dhe të aktivitetëve të tjera. Në këto ambjente konkretizohen njohuritë teorike dhe zhvillohen aftësitë praktike të studentëve. Studentët u shprehën se ndjeheshin komod në mjediset ku kryenin aktivitetin praktik.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit përfshirë këtu dhe formimin praktik sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer në institucion, GVJ konstatoi se Bibloteka e Universitetit POLIS është e pasur në tituj në fushën e arkitekturës dhe dizajnit urban. Paralel me këtë fakt, Universiteti POLIS boton</p>



të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	rregullisht revista, periodikë shkencore dhe monografi në fushën e Arkitekturës dhe Dizajnit Urban si dhe ka marrë përsipër përkthimin në Shqip të shumë prej librave bazë të mendimit të lidhur me Arkitekturën dhe Dizajnin Urban. Kjo literaturë është e shpallur në sylabusin e lëndës dhe është e aksesueshme në formë fizike në bibliotekë ose në formë dixhitale.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Njësia përgjegjëse për bibliotekën raporton në mënyrë periodike mbi përditësimin e literaturës, botimet e reja të shtuara në fondin e bibliotekës, abonimet e reja në revista dhe periodikë si dhe për zgjerimin e fondit të bibliotekës on-line. Këto raportime bëhen publike ndaj personelit akademik dhe studentëve të Universitetit POLIS.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion GVJ raporton që Universiteti POLIS vë në dispozicion të studentëve Bibliotekën mësimore me një sipërfaqe prej rreth 155 metra katrorë dhe një fond prej 10185 librash kryesisht të fushës së arkitekturës. Kjo bibliotekë kishte një fond të madh librash të skeduar dhe të moduluar sipas programeve të studimit që ofron institucioni. Biblioteka ofronte shërbimin me personel të gatshëm për t'i ndihmuar të interesuarit për të gjitha shërbimet.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe konkretisht në ambientet e bibliotekës ku dhe u zhvilluan pjesa më e madhe e takimeve, GVJ konstatoi që ajo ishte e pajisur me literaturë fizike: tekste mësimore bazë, literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe periodikë të ndryshëm të shkruar dhe elektronikë etj. Gjithashtu dhe studentët u shprehën të kënaqur me shërbimin e bibliotekës.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ konstatoi se krahas bibliotekës fizike, institucioni ofronte akses edhe në tre biblioteka online si: <ul style="list-style-type: none"> • Biblioteken online JSTOR me një numër të gjerë materialesh digjitale; • EBSCO mundësuar nga bashkëpunimi me Rrjetin Akademik Shqiptar si dhe; • Bibliotekën online të vënë në dispozicion të kërkuesve shkencorë nëpërmjet bashkëpunimit me Universitetin e Ferrarës.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi se Biblioteka e Universitetit POLIS ishte e pajisur me kompjutera dhe programet kompjuterike të nevojshme. Po kështu edhe aksesimi në fondin fizik të bibliotekës realizohej me anën e kompjuterave nëpërmjet programit të dizenuar për këtë qëllim.

<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ u informua dhe gjeti se Biblioteka e Universitetit POLIS siguron akses në informacion, dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për studentët dhe stafin.</p> <p>Biblioteka ofron shërbimet e saj në oraret: 8:30—16:30 nga e Hëna në të Premte; 9:00—17:00 të Shtunë dhe të Dielë.</p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në RVB si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton që punonjësit e bibliotekës ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, njëkohësisht edhe përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektueshmërinë dhe përpjekjet për pasurimin fondit fizik si dhe atij online.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, përfshirë bibliotekën.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni kryen menaxhimin e të dhënave me anë të platformës "Pitagora". Të gjitha zyrat brenda institucionit kanë akses në informacionin për studentët, statusin e tyre dhe ti ndjekë në vazhdimësi të studimeve të tyre deri në diplomim.</p> <p>Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me kredencialet për të aksesuar sistemin dhe me emailt institucionale. Institucioni mbante dosjet e studentëve në sekretarinë mësimore në mënyrë fizike dhe dixhitale.</p>

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, GVJ u informua se përdoret i njëjti sistem menaxhimi. Ky sistem u mundëson personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe partnerëve aksesim funksional për të menaxhuar aktivitetin e tyre në kuadrin e aktivitetit të përgjithshëm të institucionit.</p>		
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që sistemi i sipërpermendur siguron akses të dedikuar. Duke qenëse informacioni ruhet në një bazë qendrore të dhënash edhe stafi edhe studentët kanë akses në informacionin e tyre personal dhe atë që lidhet me programin e studimit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me mënyrën e funksionimit të këtij sistemi dhe konkludon që ai është mjaft i dobishëm për informimin, organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve si të studentëve ashtu edhe të stafit aktiv në programin e studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale.</p>		
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri GVJ u informua se sistemi i menaxhimit i sipërpermendur mundëson forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>		
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ konstatoi që sistemi garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Kështu nëpërmjet tij monitorohet frekuentimi i studentëve, llogaritet nota përfundimtare, njoftohet stafi akademik dhe administrativ për të drejtën e hyrjes në provim të studentëve etj. Ky sistem automatizon edhe procesin e plotësimit të kërkesave të studentëve për dokumenta të caktuara duke inicuar dhe ndjekur procesin deri në fund.</p>		
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi faqen zyrtare në internet të institucionit dhe gjeti që informacionet të cilat lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera të Universitetit POLIS publikohen në faqen e internetit në shqip dhe në anglisht.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti Polis disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton që Universiteti POLIS ka buxhet të pavarur dhe harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për cikël të plotë studimi. Buxheti mer parasysh kërkesën dhe nevojën për burime njerëzore akademike dhe administrative në shërbim të programit, burimet infrastrukturore, logjistike dhe didaktike si dhe investime afatgjata ku përfshihen pajisje për klasat, laboratore dhe investime të tjera.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga ky informacion ai mësoi që burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhej nga Zyra e Financave bazuar në zërat e miratuara në buxhet.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ mësoi se Institucioni kryen çdo vit auditimin e pasqyrave financiare nga një kompani e mirënjohur ndërkombëtare e cila konfirmon vërtetësinë dhe pasqyrimin drejt informacionit financiar. GVJ konkludon se instiucioni zotëron burimet e nevojshme financiare për ta mbështetur këtë Program Studimi.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Ky program ashtu si vetë institucioni prej vitesh ka një reputacion shumë të mirë në treg dhe është kthyer në një markë për Universitetin Polis. Edhe këtu si në gjithë institucionin është zbatuar strategjia e diversifikimit të burimeve të të ardhurave për të rritur më tej të ardhurat dhe për të ulur riskun nga goditjet nga rëniet e përkohshme të numrit të studentëve. Gjithashtu është rritur edhe spektri i aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura si pjesëmarrja në projektet të financuara nga donatorë (EU, IIK, SIDA, etj), zhvillimi i konferencave dhe wokshopeve, kurset e trajnimit dhe kualifikimit si dhe aktivitete të tjera. Çdo vit, Universiteti POLIS raporton derin në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.


Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar në raportet financiare GVJ konstaton se institucioni ka bilanc financiar pozitiv, çfarë garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ekzistencën e kapaciteteve financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare në të ardhmen.		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit kërkimor - mësikor, përfshirë këtu mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Referuar RVB dhe gjetjeve nga vizita në institucion, GVJ është informuar mbi politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. GVJ konstaton se në Rregulloren Didaktike të institucionit përshkruhen procedurat e pranimit të studentëve si: dispozitat e përgjithshme, aplikimi, transferimi, etj. Këto politika dhe procedura janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë	Në shqyrtimin e politikave dhe procedurave për pranimin, edukimin dhe diplomimin e studentëve, GVJ gjykon që ato garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Të gjithë ata që kanë aplikuar për programet e

dhe studentët e programit të studimit.	studimit në Universitetin POLIS dhe fitojnë të drejtën e studimit rregjistrohen si studentë zyrtarë dhe u nënshtrohen njëlloj të drejtave dhe detyrimeve që linden nga ky status. GVJ konstaton që në këtë institucion, si të drejtat ashtu edhe detyrimet janë të njëjta për të gjithë studentët që nga momenti kur marrin statusin e studentit deri kur diplomohen.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Gjate takimit në zyrën e pranimit, GVJ konstatoi se institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në RVB; GVJ gjykon se procedurat e pranimit, përzgjedhjes së studentëve, ato të përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, janë të aksesueshme dhe të kuptueshme nga publiku. Procedurat deri në rregjistrim janë procedura konkurruese të cilat gjenden në faqen zyrtare të universitetit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ u informua që udhëzimin e publikut dhe të interesuarve në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, në ambjentet e universitetit e organizon dhe e kryen Zyra e Pranimeve. Nga kjo zyrë kandidatët mund të marrin informacion të detajuar për universitetin dhe programin specifik të studimit. Gjithashtu të interesuarit mund t'i konsultojnë kriteret e pranimit dhe të drejtat e detyrat e tyre si studentë në faqen zyrtare të institucionit.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Shtresat e konsideruara të marginalizuara, duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara hyrëse të specifikuar në Udhëzimet e MAS dhe vendimet e Senatit Akademik. Universiteti merr në konsideratë, çdo vit në përcaktimin e kuotave për vitin akademik pasardhës këto shtresa, duke rezervuar mundësinë për shpërndarje, sipas kapaciteve në dispozicion, kuota të veçanta dhe për këto shtresa, të cilat aktualisht publikohen dhe ndërmjetësohen nëpërmjet U-Albania, ndërkohë që aplikimi dhe regjistrimi i kandidatëve kryhet direkt në njësitë përkatëse të universitetit.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Si në rastin më sipër, kandidatët nga shtetet e tjera, merren në konsideratë që në momentin e përcaktimit dhe publikimit të kuotave, ku në nivel institucioni realizohet një shpërndarje për vendet akomoduese të kandidatëve në secilin program. Gjithashtu edhe portali zyrtar, është një tjetër kanal informacioni i rëndësishëm, ku



	kandidatët e të gjithë kategorive, me diplomë vendase ose të huaj, mund të gjejnë informacion të detajuar, për kuotat dhe kriteret e pranimit në këtë program studimi.								
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Për të nxitur e përkrahur studentët nga shtresat sociale në nevojë por edhe për studentët e shkëlqyer, GVJ u njoh me politikat financiare lehtësuese, të cilat konsistojnë në subvencionimin e programeve të veçanta dhe reduktimin e tarifës së shkollimit për programe të caktuara. Përkrah këtyre Universiteti POLIS me mbështetjen e “Bordit të Themeluesve” në kuadër të politikave dhe misionit social të institucionit, por dhe sipas një procedure të mirëpërcaktuar me ligj, rregulla dhe afate kohore, ofron tarifa të reduktuara për studentët që i përkasin shtresave në nevojë.								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstatoi se Universiteti POLIS informon studentët në lidhje me kriteret, procedurat e përparimit akademik të tyre, në lidhje me programin e studimit dhe procesin mësimor me anë të disa burimeve të informacionit. Një pjesë të informacionit studentët e gjejnë në Statutin e institucionit, rregulloret, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj të cilat mund ti aksesojnë elektronikisht ose fizikisht. Ndërsa informacionin në lidhje me ecurinë e tyre personale e aksesojnë nëpërmjet sistemit PITAGORA. Të njëjtën gjë e konfirmuan dhe studentët gjatë takimit me ta.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	GVJ konsultoi RVB dhe, gjatë vizitës në institucion, mësoi për punën që bëhet në informimin e studentëve lidhur me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme. Në këtë kuadër konstatohet që sipas direktivave dhe rregulloreve çdo student, informohet rregullisht për procedurat dhe afatet e njohjes së diplomës së studimeve të mëparshme. Studentët gjithashtu informohen për njohjen e diplomës bazuar në akreditimin e programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	GVJ konstaton që në Universitetin POLIS studentët informohen rregullisht në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e

procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	aftësive të studentëve në programin e studimit. Ky konstatim konfirmohet si nga gjetjet në RVB ashtu edhe informacionet nga vizita në institucion. Përveçse në dokumentacionin ligjor të Universitetit kriteret dhe procedurat e vlerësimit jepen edhe në syllabuset e lëndëve.		
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Edhe në lidhje me këtë kriter GVJ konstatoi se informacioni që i përcillet studentëve është i plotë dhe i qartë. Pasi sic është shpjeguar në hollësi dhe në Standartin III.8, gjatë gjithë periudhës së punimit të diplomës studentët janë të mbikqyrur dhe të udhëhequr nga një grup pedagogësh që monitorojnë dhe mbështesin studentin gjatë këtij procesi.		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe gjatë takimeve në Universitetin POLIS, GVJ konstaton se institucioni informon të interesuarit apo studentët e ardhshëm të këtij programi nëpërmjet faqes zyrtare dhe mediave sociale, ku publikon informacionet më të përditësuara lidhur me programin. Ndërkohë, Zyra e Pranimeve dhe Departamenti organizojnë takime të hapura me maurantët e gjimnazeve të interesuar për këtë program studimi. Gjithashtu Universiteti publikon udhëzues në formën e broshurave për të informuar studentët e ardhshëm në lidhje me aspekte të ndryshme të këtij programi studimi.		
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton që informimi i studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale është i aksesueshëm në faqen e Universitetit. Gjithashtu Departamenti organizon takime orientuese për të informuar studentët në lidhje me: përmbajtjen e programit të studimit, për lëndët, ngarkesën mësimore, frekuentimin, syllabuset e detajuara, materialet mësimore, oraret, datat e provimeve, objektivat e kurseve, sistemin e vlerësimit etj.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/	Nëpërmjet RVB dhe vizitës në Institucion, GVJ u informua mbi Kurrikulën dhe syllabuset e lëndëve të programit të studimeve Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale. Këto materiale u vihen në

udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	dispozicion në fillim të çdo viti studentëve të këtij programi studimi. Kjo bën që ata të jenë të mirëinformuar për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.		
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstaton se përmbushja e këtij kriteri realizohet nëpërmjet aktivitetit të Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës. Referuar RVB, kjo zyrë i orienton dhe i mbështet studentët në krijimin e dokumentacionit sa më të përshtatshëm për të konkuruar në tregun e punës. Zyra ndërmjetëson kontaktet dhe i finalizon ato.		
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në Universitetin POLIS studentët e marrin informacionin mbi zhvillimin e procesit mësimor të plotë dhe të përditësuar. GVJ konstaton se studentët i konsultojnë të gjithë burimet e informacionit. Në takimin me ta, studentët demonstrojnë njohje të plotë të informacionit mbi procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet.		
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstaton që informacioni në lidhje me programin e studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale është i plotë në Platformën "PITAGORA" e cila njihet mirë nga studentët dhe përdoret në çdo kohë e lehtësisht prej tyre pavarësisht nga distanca.		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë lidhur me objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënies dhe mundësitë e punësimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstaton se Institucioni disponon të gjithë informacionin në lidhje me studentët e regjistruar, larguar, diplomuar dhe të dhëna të tjera statistikore të cilat mbahen nga Sekretaria Mësimore në bazë të formateve të përcaktuara nga MAS, si në Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloren Didaktike të Universitetit. Institucioni i ruan këto informacione në format elektronik ashtu dhe në regjistra si: Regjistri i Procesit Mësimor, Regjistri i Notave, Regjistri Themeltar dhe Regjistri i Diplomave të cilat arkivohen në fund të çdo semestri.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e	GVJ konstaton që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë,

studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto statistika ndodheshin ne Sekretarinë Mësimore.		
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në takimin me Sekretarinë Mësimore GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat lidhur me studentët e Programit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale ruhen në mënyrë të sigurtë në sistemin e brendshëm i cili gjeneron automatikisht të gjitha statistikatat e kërkuara nga MAS apo institucionet përkatëse. Ky sistem është funksional, i sigurtë dhe të dhënat janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.		
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Në lidhje me Dokumentacionin e studentëve, kontrolli paraprak i tyre bëhet në fazën e aplikimit nga Njësia Bazë e përfaqësuar nga Departamenti, nën supervizionin e Dekanit të Fakultetit. Procesi i Dorëzimit të dokumentacionit të Studentit, përfundohet dhe kontrollohet nga Sekretaria në fazën e regjistrimit dhe i gjithë procesi supervizohet nga Zyra Juridike e cila finalizon edhe kontratat studentore. Veprimtaria e plotë studentore gjatë studimeve, pasqyrohet dhe përditësohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit "Pitagora", e cila në rastet kur paraqitet e nevojshme, kontrollohet dhe vlerësohet edhe nga Njësia Kryesore dhe ajo Bazë.		
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Universiteti disponon informacion të plotë në lidhje me studentët e rinj, gjithashtu, harton një raport pas diplomimit, lidhur me cilësinë në dalje të tyre. Dekanati studion kuptimin e rezultateve me qëllim orientimin e programit në formën e duhur për ti ofruar studentëve një program sa më efikas dhe frytdhënës në aspektin profesional.		
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se institucioni administron dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe nga takimet ne institucion GVJ konstaton se angazhimi i studentëve administrohet nga Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët i krijuar bazuar në statutin e Universitetit POLIS. Anëtarët e komisionit propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati Akademik për një mandat dy vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Komisioni përbëhet nga 5 anëtare, përkatësisht: 3 Zëvendës Drejtues të njësive kryesore, 1 përfaqësues i stafit akademik dhe 1 përfaqësues i stafit administrativ. Gjithashtu një përfaqësues i studentëve është anëtar i senatit akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton që bazuar në Statutin e Universitetit POLIS, studentët përfaqësohen në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik në Universitet, përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Gjithashtu studentët kanë një organ të pavarur që është Këshilli Studentor, i cili promovon dhe kooordinon përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Format e mësimin konkretizohen në hartimin nga dekanati të strukturës mësimore për programin e studimit si dhe orari i mësimin, i cili hartohet në përputhje me planin mësimor. Këshilli i Studentëve nëpërmjet përfaqësimit të tyre në organet vendimmarrëse shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit, si për planet e programet e studimeve, rregulloret dhe veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve, të drejtën për të studiuar, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësies/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehën se u është mundësuar të japin mendime mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit të tij dhe reflektimit nga ana e institucionit përkatësisht njësies dhe pedagogut përgjegjës. Institucioni angazhon njësinë bazë dhe njësinë kryesore për të garantuar të drejtat e studentëve në këto raste.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se institucioni mbështet dhe informon studentët nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) gjatë gjithë periudhës së studimit. Nëpërmjet kësaj zyre studentët marrin informacionet e nevojshme lidhur me rregulloret e ndryshme të institucionit, procesin mësimor, këshillimin për praktikat profesionale etj.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Edhe për përbushjen e këtij kriteri GVJ mësoi që në Universitetin POLIS është ngritur dhe funksionon infrastruktura e posaçme organizative dhe logjistike.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstatoi që në Universitetin POLIS, Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës kryen të gjitha shërbimet e këshillimit të karrierës. Duke qënë njësia që mban lidhje të vazhdueshme me kompani te ndryshme, kjo Zyrë mirëpret studentët që ata të informohen lidhur me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Kjo zyrë i ofron studentëve këshillimin dhe orientimin e nevojshëm në lidhje me kryerjen e praktikave profesionale dhe orientimin e tyre në tregun e punës.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve	Edhe për përbushjen e këtij kriteri një rol parësor kishte Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës. GVJ u informua që kjo zyrë mbledhte, përpunonte dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve të programit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale. Këto të dhëna ajo ua vinte në dispozicion si studentëve po ashtu edhe organeve e autoriteteve mbështetur në kërkesën e tyre.

dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave dhe janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ u informua se institucioni harton udhëzues dhe metodologji për të mbështetur personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Universiteti POLIS ka hartuar udhëzues dhe metodologji për përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave didaktike edhe nëpërmjet projekteve Europiane të rritjes së kapaciteteve ERASMUS+. Në këto raste personeli akademik trajnohet nga kolegë të universiteteve partnere ndërkombëtare në fushat e metodologjive të mësimdhënies, në udhëheqjen e punës kërkimore të studentëve, në menaxhimin e proceseve akademike etj.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Universiteti POLIS, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme, ka ngritur një njësi të qëndrueshme, strukturimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i së cilës përcaktohet qartë në Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit POLIS.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Universiteti POLIS, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme, ka ngritur një njësi të qëndrueshme, strukturimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i së cilës përcaktohet qartë në “Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë”. Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive

	akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit POLIS.						
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Proceset dhe vlerësimet periodike trajtohen në formën e gjetjeve dhe si të tilla organizohen në formën e një raporti me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave për rastet kur është e nevojshme. Gjetjet e raporteve të NJBSC-së në lidhje me cilësinë janë transparente, nëpërmjet mailit dhe prezantimit në Senatit Akademik. Në varësi të gjetjeve çdo njësi bazë por dhe kryesore rishikon dhe përmirëson procedurat, lëndët e ofruara etj. në planin e aktivitetit të tyre vjetor. Në këtë mënyrë njësitë përgjegjëse ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së ofruar në nivel programi.						
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në fund të çdo viti akademik NJBSC, përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë i cili i paraqitet në formë zyrtare Rektoratit për t'ju vënë në dispozicion Senatit Akademik. Bazuar në të dhënat e raportit nxirren rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procesit të cilësisë dhe mësimdhënies dhe sigurohet që ato të zbatohen në çdo njësi të institucionit.						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton se Universiteti POLIS në strukturën e tij, ka një njësi përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë që funksionon në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Ngritja dhe funksionet e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë janë të bazuara respektivisht në Statutin e Institucionit si dhe Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku	Bazuar në RVB dhe në takimin me anetarët e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë GVJ konstaton se NJBSC është një njësi e përhershme e pavarur, e angazhuar në menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave të ngritura për këtë qëllim.


përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstaton se kjo njësi përbëhet nga 9 anëtarë dhe operon bazuar në rregulloren NJBSC. Drejtues të njësisë përzgjidhen nga pedagogët e brendshëm dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të studentëve, të të diplomuarve dhe bashkëpunëtorë të institucionit nga industria.						
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti POLIS përdor Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative si dhe metodologji dhe instrumenta për matjen e cilësisë së proceseve akademike. Institucioni i nënshtrohet proceseve të Akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit. Studentët janë gjithashtu të përfshirë në përgatitjen e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm të përgatitur në kuadër të akreditimit të institucionit dhe programeve të studimit.						
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Universiteti ka hartuar Politikën e Cilësisë dhe Politikën për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit. Kjo politikë synon të sigurojë dhe të përmirësojë cilësinë e programeve të studimit, si dhe për të krijuar një kulturë të cilësisë në nivelin institucional.						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe	Institucioni posedon mekanizma formale për monitorimin e programeve të studimit si NJBSC, Këshillat e Fakulteteve, Senati Akademik, Rektorati etj. Me anë të këtyre mekanizmave institucioni kryen mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Procedurat e kontrollit të cilësisë janë të formalizuara në rregulloren përkatëse.

<p>dobësi, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në takimin me anëtarët e NJBSC, GVJ konstatoi se kjo njësi përgatit një raport periodik të vlerësimit të cilësisë dhe ia paraqet në formë zyrtare Rektoratit dhe Senatit Akademik. Bazuar në informacionin e pasqyruar në këtë raport institucioni merr masat e nevojshme për adresimin e mangësive të konstatuara dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti POLIS përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj. Institucioni kryen vlerësimin e proceseve mesimore në tre forma në mënyrë kumulative si: pyetësorin e studentëve, vlerësimin nga kolegët dhe vetëvlerësimin.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin</p>	<p>Institucioni nëpërmjet NJBSC dokumenton Raportet e Vlerësimit të brendshëm në mënyrë që të monitorojë ecurinë e programeve në vazhdimësi. Kjo njësi vendos raportet e vlerësimit në dispozicion të departamentit, fakultetit, rektoratit dhe senatit akademik si organe vendimmarrëse të institucionit.</p>



apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.									
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni monitoron dhe vlerëson përmes njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i strukturës dhe dokumentacionit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, u konstatua se institucioni ka ngritur mekanizmat e mjaftueshme, me përfaqësues anëtarësh të brendshëm dhe të jashtëm. Njësia e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. NJBSC përbëhet nga 9 anëtarë, mes të cilëve një Kryetar, një anëtar i stafit akademik me kohë të plotë pa detyra drejtuese, anëtarë të stafit administrativ, përfaqësues të të diplomuarve të Universitetit, si dhe një specialist i jashtëm me përvojë në çështjet e sigurimit të cilësisë dhe student dhe përfaqësues të industrisë.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ konstaton se Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në NJBSC dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave si me poshtë: 1. Kryetarit të njësisë, 2. Anëtari i nga stafi akademi më me eksperiencë në këtë fushë, 3. Anëtari përgjegjës i vlerësimit të procesit mësimor nga studentët dhe vetëvlerësimi, 4 dhe 5. përfaqësues nga stafi akademik, 6. përfaqësues nga administrata 7. përfaqësues i studentëve, 8. përfaqësues nga komuniteti ALUMNI, dhe 9. përfaqësues nga industria.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative	Gjatë takimit me drejtuesit dhe me stafin e programit të studimit GVJ konstatoi se Departamenti, si njësia bazë, është përgjegjëse për mirë funksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Konstatohet se përgjegjësi i programit të studimit, personeli akademik e administrativ, si dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë.

dhe studentëve të programit të studimit.							
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se institucioni është i angazhuar për të garantuar integritetin akademik dhe barazinë kundrejt personelit dhe studentëve. Senati Akademik i Universitetit është struktura që vlerëson, garanton dhe është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në institucion, në përputhje me integritetin akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.						
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Sikurse u shpreh dhe në kriterin 2 pjesë e NJBSC janë dhe 2 anëtarë, bashkëpunëtorë të jashtëm, njëri prej të cilëve është përfaqësues nga komuniteti i të diplomuarve nga Universiteti POLIS dhe tjetri përfaqësues nga industria apo biznesi. Këta bashkëpunëtorë të jashtëm japin ekspertizë të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e NJSBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se Institucioni, nëpërmjet NJBSC është i angazhuar në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Kjo njësi mbulon jo vetëm procesin e mësimdhënies, por edhe funksionet kërkimore dhe administrative. Gjetjet e raporteve të NJBSC-së në lidhje me cilësinë institucioni i bën transparente për studentët dhe të gjithë të interesuarit dhe i vë në dispozicion të Senatit Akademik. Mbledhja e senatit organizohet si mbledhje e hapur për të gjithë stafin dhe përfaqësuesit e studentëve.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Nga takimet me stafin akademik të programit të studimit Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale, GVJ konstatoi se stafi ndjehet komod me mekanizmat e vlerësimit të përdorur nga Institucioni dhe shprehen se u respektohen liria dhe etika akademike.

legjislaconin për të dhënat personale.									
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Analiza e departamentit është e bashkangjitur në shtojcat e RVB. Forma e Planit të Veprimit hartohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të adresuar rekomandimet nga Bordi i Akreditimit dhe përfshin afatet kohore për plotësimin e secilit rekomandim. Gjithashtu, njësitë administrative dhe akademike përgatisin plane veprimi në përgjigje të gjetjeve të kontrollit të brendshëm të Universitetit.								
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Politikat dhe Procedurat e Sigurimit të Cilësisë janë zyrtarisht të miratuara, të dokumentuara dhe janë rishikuar dhe zhvilluar si përgjigje ndaj ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përmirësimin e vazhdueshëm.								
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me fakultetet, organizon seanca informimi për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të pedagogut të lëndës për përmirësimin e programit të studimit.								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional
në Arkitekturë Dixhitale ofruar nga Universiteti Polis

a. Pika të forta

1. Programi Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale mbulon një segment të tregut në rritje dhe të pa mbuluar deri më sot me programe të ngjashme studimi.
2. Programi Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale funksionon në mënyrë komplementare me programet e tjera të organizuara nga institucioni duke patur kështu mundësi të aksesojë dhe të pasurojë burime dhe ekspertizë më të gjerë se vetëm ajo e një programi studimi.
3. Institucioni ka vënë në dispozicion të programit të studimit struktura administrative, instrumente, financime dhe personelin e përshtatshëm për organizimin dhe mbarëvajtje e programit.
4. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është ekspert në fushën e interesit dhe zotëron kualifikimet e nevojshme për të garantuar cilësinë e mësimdhënies.
5. Studentët e programit të studimit angazhohen në punë praktike dhe kërkimore falë angazhimit të institucionit në rrjete profesionale dhe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
6. Në përfundim të programit të studimit, studentët kanë mundësi të aksesojnë tregun e punës me kompetenca të reja si dhe u jepet mundësia të zhvillojnë më tej ekspertizën e tyre shkencore e profesionale falë programeve profesionale e LLL apo programeve ekzekutive dhe doktorale të ofruara nga institucioni në këtë fushë.
7. Studentët e programit të studimit kanë mundësi të përdorin pajisje të avancuara të fushës së arkitekturës dixhitale falë pranisë së laboratoreve të prototipizimit dhe të dixhitalizimit në institucion. Këto laboratore përdoren gjerësisht nga studentët gjatë procesit akademik.
8. Institucioni organizon rregullisht aktivitete dhe konferenca ndërkombëtare ku trajtohen gjerë dhe thellë tematikat që interesojnë programin e studimit. Këtu mund të përmendet Tirana Architecture Week, Tirana Design Week, eCAADe RIS etj.
9. Organizimi i lëndëve ka karakter praktik dhe ndërdisiplinor, duke i pajisur studentët me njohuri dhe aftësi shumë të dobishme në tregun e punës bashkëkohor.
10. Prania e personelit akademik ndërkombëtar i ballafaqon studentët me njohuri dhe teknika të domosdoshme për të qenë të suksesshëm në një treg të hapur e ndërkombëtar.
11. Studentët marrin pjesë në përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të programit mësimor dhe të metodologjive të mësimdhënies falë pjesëmarrjes në sistemin e vlerësimit 360 grade. Informacioni dhe feedback-u që merret në këtë proces shërben për rishikimin e programit dhe metodologjive të mësimdhënies.
12. Studentët e programit të studimit kanë akses në një bibliotekë të pasur fizike dhe on-line ku gjendet literaturë bazë, ajo e këshilluar si dhe literaturë specifike për të gjitha lëndët e modulet e programit të studimit.
13. Studentët dhe personeli akademik kanë akses në platforma dixhitale për organizimi, dokumentimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Këto platforma si Pitagora, Google G-Suit dhe TurnItIn mund

të aksesohen pa limit dhe kufizime nëpërmjet account-it institucional me të cilin pajiset çdo student dhe pedagog.

14. Infrastruktura e vënë në dispozicion të programit të studimit është e bollshme dhe bashkëkohore.

b. Pikat e dobëta

1. Pjesëmarrja në Senatin Studentor si dhe organizmat e tjerë kolegiale të U_POLIS është relativisht e ulët dhe kjo sepse një përqindje e lartë të studentëve të këtij programi janë në marrëdhënie pune, por edhe si rezultat i kohës të zgjatur të programit të studimit (1.5 vite për 60 kredite). Kjo ndikon edhe në pjesëmarrjen e ulët të studentëve në aktivitete extra-kurrikulare, apo ato rekreative dhe sociale të organizuara nga universiteti.

c. Rekomandime

1. Institucionit, të rrisë përpjekjet për të rritur pjesëmarrjen në Senatin Studentor si dhe organizmat e tjerë kolegiale të U_POLIS të studentëve të këtij programi, si edhe në pjesëmarrjen e tyre në aktivitete extra-kurrikulare, apo rekreative dhe sociale të organizuara nga universiteti.
2. Rekomandohet që institucioni të jetë sa më shumë i pranishëm në iniciativa ku promovohet dhe nxitet edukimi profesional me qëllim që programet Master Profesional të marrin gjithnjë e më shumë rol në kontekstin e punësimit në vend.

Conclusions of the evaluation of the second cycle study program Professional Master in “Digital Architecture” of University Polis

a. Strengths and Affirmations:

1. The Professional Master's Program in Digital Architecture covers a segment of the growing market that has not yet been covered by similar study programs.
2. The Professional Master's Program in Digital Architecture works in a complementary way with other programs organized by the institution, thus having the opportunity to access and enrich resources and expertise wider than just that of a study program.
3. The institution has made available to the study program administrative structures, instruments, financing and suitable personnel for the organization and running of the program.
4. The academic staff engaged in the study program is an expert in the field of interest and possesses the necessary qualifications to guarantee the quality of teaching.
5. Students of the study program engage in practical and research work thanks to the institution's commitment to national and international professional and research networks.
6. At the end of the study program, students have the opportunity to access the labor market with new competencies and are given the opportunity to further develop their scientific and professional

expertise thanks to the LLL professional programs or executive and doctoral programs offered by the institution in this field.

7. Students of the study program have the opportunity to use advanced equipment in the field of digital architecture thanks to the presence of prototyping and digitization laboratories in the institution. These laboratories are widely used by students during the academic process.
8. The institution regularly organizes activities and international conferences where topics that interest the study program are dealt with in depth and breadth. Tirana Architecture Week, Tirana Design Week, eCAADe RIS etc. can be mentioned here.
9. The organization of subjects has a practical and interdisciplinary character, equipping students with knowledge and skills very useful in the contemporary labor market.
10. The presence of international academic staff provides students with knowledge and techniques necessary to be successful in an open and international market.
11. Students participate in the continuous improvement and updating of the curriculum and teaching methodologies thanks to participation in the 360-degree evaluation system. The information and feedback obtained in this process serve to revise the program and teaching methodologies.
12. Students of the study program have access to a rich physical and on-line library containing basic, recommended and specific literature for all subjects and modules of the study program.
13. Students and academic staff have access to digital platforms for organizing, documenting and running the learning process. These platforms such as Pitagora, Google G-Suit and TurnItIn can be accessed without limits and restrictions through the institutional account with which every student and lecturer is equipped.
14. The infrastructure made available to the study program is ample and modern.

b. Weaknesses:

1. Participation in the Student Senate as well as other collegiate bodies of U_POLIS is relatively low and this is because a high percentage of students in this program are in employment, but also as a result of the extended time of the study program (1.5 years for 60 credits). This also affects the low participation of students in extra-curricular activities, or recreational and social activities organized by the university.

c. Recommendations:

1. The institution, to increase its efforts to increase the participation in the Student Senate as well as other collegiate bodies of U_POLIS of the students in this program, as well as in their participation in extra-curricular, or recreational and social activities organized by the university.
2. It is recommended that the institution be present as much as possible in initiatives where professional education is promoted and encouraged in order for the Professional Master programs to take more and more role in the context of employment in the country.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

